0651/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI
Drejtoria Juridike

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 228402, FAX: +4 223981

Nr. 13-K 1 Prot.

Tiranë më 11.5.2015

Lënda: Kthehet përgjigje

Kërkuesit: **Sokol Abazi**

Adresa:Rr."Todi Shkurti",
nr.9, shk.2, H.2, Lagjia 1,
Email:sokolabazi@hotmail.com
Tiranë

Qendrës "Res Publica"
Përfaqësuesit Dorian Matlija

Adresa:Blv."Gjergj Fishta",
Ndërtesa 24, Hyrja 3, ap.44
Email:dorian.matlija@gmail.com
Tiranë

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Universitetit të Tiranës, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni mbi listat e kandidatëve në programet e doktoraturës të vitit 2012-2013 në FSHN, bazën ligjore të aplikuar, të dhëna për kandidaten Entela Hodon etj, rregjistruar me numër rendor 13-K datë 30.4.2015 (sipas Rregjistrit përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve).

Lidhur me sa kërkoni, i gjithë dokumentacioni zyrtar i protokolluar i cili qëndron në ruajtje në arshivat e Fakultetit të Shkencave të Natyrës lidhur me procedurën e pranimeve dhe regjistrimeve në studimet e ciklit të tretë të doktoraturës në vitin akademik 2012-2013 në këtë fakultet, ju është vënë në dispozicion me shkresat nr.404/4 datë 18.2.2015, nr.4-K/1 datë 2.3.2015 dhe nr.7-K/3 datë 2.4.2015.

Gjatë dhënies së informacionit, nga ana jonë është mbajtur parasysh ruajtja e të dhënave personale të cilat kanë të bëjnë me kandidatët, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimit, vlerësimet dhe vendimet konkrete për secilin sipas nenit 5 të ligjit nr.9887 datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar. Ndodhur në këto kushte, refuzohet kërkesa për dhënie të informacionit të detajuar për kandidaten Entela Hodo, dhe po për të njëjtën arsye,

refuzohet kërkesa për vënie në dispozicion të shkresës nr.1318/33 datë 12.11.2013 të Rektorit të UT, pasi përmban të dhëna përshkruese të kandidatëve fitues si moshën, vendlindjen, datëlindjen, atësinë, vendbanimin, kualifikimet, arsimimin, etj. Ato përbëjnë të dhëna personale të cilat jo vetëm nuk mund të jepen pa miratim të personave konkret, por që asgjësohen me mbarimin e qëllimit për të cilin janë mbledhur.

Për kërkesën mbi vënie në dispozicion të shkresave nr.1318/20 datë 4.7.2013 dhe nr.1318/25 datë 15.7.2013 të Rektorit, përsa nuk përmbajnë të dhëna personale, bashkëlidhur ju dërgojmë një kopje të tyre së bashku me dy propozimet e sjella nga FSHN.

Lidhur me kërkesën për vënien në dispozicion të procesverbalit të Departamentit të Kimisë përcjellë me shkresën nr.3594/7 datë 6.2.2015, vendimit nr.17 datë 9.2.2015 dhe kontratës tip, në arshivat e UT nuk gjendet shkresa me këto numra që të kenë të bëjnë me procedurat e pranimeve në doktoraturë në FSHN për vitin akademik 2012-2013.

Sqarojmë përfundimisht se procedurat e pranimeve në doktoraturë zhvillohen sipas ligjit për arsimin e lartë nenet 19, 21 e 26; VKM nr.864 datë 5.12.2007; Udhëzimit nr.21 datë 30.7.2009 i MASH, Statutit të UT nenet 25 pika 18, 42 dhe 49; si dhe Rregullores "Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave" të UT. Për më tepër informacion për legjislacionin që zbatohet në këtë drejtim, mund të konsultoheni me Programin e Transparencës të UT të publikuar në portalin unitir.edu.al.

Kundër kësaj përgjigje mund të bëni ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

UNIVERSITETI I TIRANËS - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REKTORI
DHORI KULE

UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

ZYRA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE E PROJEKTEVE

Nr. 1318/20 *Prot.* *Tiranë më,* 04.7.*2013*

Lënda: *Mbi kandidatët për vijimin e studimeve të doktoratës, pranë FSHN, për vitin akademik 2012-2013*

FAKULTETIT TË SHKENCAVE NATYRORE
Dekanit, Prof.Dr. Mynyr KONI

Në vijim të shkresave tuaja nr. 1146/4 prot., datë 24.06.2013, dhe nr. 1234/3 prot., datë 24.06.2013 lidhur me informacionin e përcjellë nga strukturat tuaja për kandidatët e propozuar fitues për vijimin e studimeve të doktoratës pranë FSHN, UT, për vitin akademik 2012-2013, miratoj propozimet e përcjella nga ju.

Për sa më lart, të dërgohet informacioni përkatës për propozimet për rialokim kuotash për studimet e doktoratës.

R E K T O R I

Dhori K U L E

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Tiranë, më 24.04.2013
Nr. 1146 Prot.

Lënda: *Propozim për miratim si raste të veçanta në Dokotraturë, viti akademik 2012-2013.*

REKTORATIT

Nga shqyrtimi i aplikimeve në programet e ndryshme të Ciklit të Tretë, Doktoraturë, ka patur raste që mesatarja 8 e lart e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimit (ose DIND) ka kufizuar pranimin e studentëve në Doktoraturë.
Për plotësimin e këtyre kuotave në disa programe të Doktoraturës propozojmë për miratim si raste të veçanta kandidatët e mëposhtëm:

I. Kandidatë të cilët janë pedagogë në Institucione të Arsimit të Lartë.

Programi i Doktoraturës Bioteknologji Bimore
1. Stela Papa (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT)
2. Matilda Zeqo (Universiteti i Vlorës)
3. Gazmir Gjoni (Universiteti i Durrësit)

Programi i Doktoraturës Informatikë
1. Dhori Terpo (Univeristeti i Gjirokastrës)
2. Roland Vasili (Univeristeti i Gjirokastrës)

II. Kandidatë të cilët kanë notë mesatare 7.9 të DIND dhe kanë mbaruar MND me rezultate të larta.

Programi i Doktoraturës Biologji e Ruajtjes
1. Ermira Milori
2. Mimoza Milo

III. Kandidat me aktiviteti të lartë botues në revista ndërkombëtare, me mesatare të lëndëve të specialitetit në DIND 8.07 dhe ka mbaruar MND me rezultate të larta.

Programi i Doktoraturës Analizë dhe Algjebër
1. Kastriot Zotaj

DEKANI

MYNYR KONI

Adresa: Bulevardi " Zogu I ", Nr. 25/1, Tiranë, Tel. & Fax: +355 4 2229590. www.fshn.edu.al

UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

ZYRA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE E PROJEKTEVE

Nr. 1318/25 *Prot.* *Tiranë më,* 15.7. *.2013*

Lënda: *Lidhur me propozimet për kandidatët për alokim në disa programe studimi doktorate, pranë FSHN, UT, për vitin akademik 2012-2013*

FAKULTETIT TË SHKENCAVE NATYRORE
Dekanit, Prof.Dr. Mynyr KONI

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1430/1 prot., datë 08.07.2013, lidhur me propozimet tuaja për disa kandidatë për vijimin e studimeve të doktoratës, sipas programeve përkatëse të studimit, miratoj sa parashtroni në shkresën tuaj të sipërpërmendur.

REKTORI

Dhori KULE

a: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, Tel: 228402,Fax: 223981,
www.unitir.edu.al

22
013

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Tiranë, më 08.07.2013

Nr. 1430/1 Prot.

Lënda: Dërgohen propozimet e kandidatëve për alokim në disa programe studimi doktorate

57

REKTORIT TË UT,

Prof.Dr. Dhori KULE

Në vijim të shkresës tonë Nr. 1430 Prot. datë 23.05.2013 dhe përgjigjes tuaj pozitive me shkresë Nr. 1318/20, datë 04.07.2013 po ju dërgojmë propozimet tona për kandidatët e mëposhtëm sipas programeve të studimit përkatës të doktoratës:

1. Bioteknologji a) Laura Binxhija (Troje)
2. Biologji e ruajtjes a) Besnik Rexhepi (Troje) b) Nasuf Abdii (Troje)
3. Biologji molekulare a) Mimoza Kuçi b) Lulzime Kokiçi c) Ermira Hoxhaj
4. Fizikë a) Eglantina Merkaj b) Klotilda Nikaj c) Malvina Marku
5. Teknologjia dhe mikrobiologjia e ushqimeve dhe vlerësimi i cilësisë dhe sigurisë
   a) Entela Hodaj
6. Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe mbeturinave industriale urbane
   a) Silvana Gjyli

Bashkëngjitur keni një informacion më të plotë për çdo kandidat.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DEKANI

MYNYR KONI

Adresa: Bulevardi " Zogu I ", Nr. 25/1, Tiranë, Tel. & Fax: +355 4 2229590. www.fshn.edu.al